

## IN MEMORIAM

**Prof.dr. SHEFQET PLLANA (1930-1994)**

Më 4 janar 1994 vdekja e pamëshirshme befasisht rrëmbeu Shefqet Pllanën, profesor ordinar në Degën e Letërsisë dhe të Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Lajmi i zi i vdekjes tronditi zemrat tona, sepse mbetëm përgjithmonë pa pedagogun e shquar, pa studiuesin e zellshëm, pa kolegun dhe mikun e çmuar.

Prof. dr. Shefqet Pllana, lindi më 18 mars 1930 në Ferizaj. Pasi kreu shkollën fillore dhe të mesme, punoi si mësues. Në vitin 1952 i regjistroi studimet në Grupin e Albanologjisë të Fakultetit Filozofik të Beogradit, ku diplomoi më 1957. Pas studimeve punoi në Shkollën Normale të Prishtinës. Me themelimin e Fakultetit Filozofik të Prishtinës, në vitin 1962, u zgjodh bashkëpunëtor profesional në Grupin e Albanologjisë. Këto vite Katedra e Albanologjisë filloi të botojë revistën shkencore "*Gjurmime albanologjike*", në redaktimin e së cilës profesor Pllana dha ndihmesë të madhe. Kur kreu studimet pasuniversitare në Beograd, u zgjodh ligjërues i letërsisë popullore në Degën e Gjuhës Shqipe të Fakultetit Filozofik, kurse disertacionin e doktoraturës "*Poezia popullore e sotme e shqiptarëve të Kosovës*", e mbrojti më 1970 në Fakultetin Filozofik të Beogradit. Një vit më vonë merr titullin docent i letërsisë popullore. Më 1975 në mbështetje të punës së frytshme pedagogjike dhe shkencore, bëhet profesor inordinar, kurse në vitin 1980 arriti gradën më të lartë universitare - profesor ordinar. Profesor Shefqet Pllana vite me radhë ligjëroi letërsinë gojore edhe në Degën e Gjuhës Shqipe të Universitetit të Shkupit. Po ashtu mori pjesë aktive në udhëheqjen dhe në drejtimin e Fakultetit të Filologjisë dhe të Degës së Letërsisë dhe të Gjuhës Shqipe në Prishtinë. Një kohë ishte kryetar i degës dhe dekan i Fakultetit të Filologjisë. Si dekan u angazhua dhe ka merita në organizimin e studimeve dhe të punës në fakultetin pas dëbimit me dhunë prej pushtuesit serb nga ndërtesat e fakultetit.

Veprimtaria shkencore e profesor Shefqet Pllanës është e gjerë dhe e pasur. Profesor Pllana qysh gjatë studimeve tregoi interesim për problemet e letërsisë gojore në tërësi. Vepra e tij shkencore përfshin mbi 100 njësi bibliografike. Në fushën e folkloristikës shqiptare ai ishte njëri ndër ekspertët, i cili, përveç gjurmimeve sistematike të lëndës folklorike në terren, me kompetencë shkencore është marrë sidomos me problemet teorike të folklorit shqiptar. Çështjet e shumta të letërsisë gojore shqiptare i studioi jo në mënyrë të izoluar, jo vetëm brendapërbrenda sistemit folklorik shqiptar, por edhe në plan komparativ me folklorin e popujve balkanikë dhe më gjerë. Interesimet e profesor Pllanës përfshijnë pothuajse të gjitha gjinitë e letërsisë gojore. Në fushën e lirikës sonë gojore ai studioi këngët e motmotit, këngët e punës, këngët e dashurisë etj. Po ashtu baladat, eposi legjendar dhe historik, llojet e prozës popullore etj., ishin preokupim i studimeve të tij. Kishte informacion të saktë mbi atë që është shkruar te ne dhe në botë për probleme e çështje që merrte në shqyrtim. Çështjet e shumta të

strukturës artistike të llojeve të letërsisë gojore ai i studioi në diakroni dhe në sinkroni, me shkathtësi shkencore analitike dhe sintetizuese.

Profesor Shefqet Pllana rezultatet e veta shkencore i ka kumtuar në simpoziume, kongrese, tubime shkencore etj. në Prishtinë, Shkup, Ohër, Novi Sad, Zagreb, Bled, Lubjanë, Beograd, Mostar, Zhablak, Rozhajë etj., si dhe më gjerë në Sofje, Athinë, Grac, Vjenë, Insbruk, Tiranë, Bukuresht, Stamboll etj. Në seancat e këtyre tubimeve shkencore, disa nga të cilat i ka drejtuar me sukses, profesor Sh. Pllana ka marrë pjesë aktive në diskutime, me ç'rast i ka ndriçuar dhe i ka plotësuar çështjet e rrahura. Pjesëmarrja e tij sidomos në tubimet shkencore ndërkombëtare ka rëndësi, sepse e ka afirmuar kulturën tonë popullore dhe folkloristike shqiptare.

Nga studimet që shënojnë rezultate të veçanta të profesor Shefqet Pllana në fushën e folkloristikës shqiptare janë: *Puna në këngët popullore shqiptare*, "Gjurmime albanologjike" 2, Prishtinë, 1965; *Folklori sot si problem shkencor dhe shoqëror*, "Jehona", 9-10, Shkup, 1965; *Skënderbeu në krijimtarinë gojore të Kosovës dhe të Maqedonisë*, "Simpoziumi mbi Skënderbeun", Prishtina, 1969; *Buzmi*, "Narodna stvaralaštvo", Beograd, VIII, 1970; *Elementet e përbashkëta dhe të veçanta të këngëve të popujve ballkanikë me temën e rinjohjes së burrit me gruan*, "Balcanica", II, Beograd, 1971; *Këngët e martesës ndër shqiptarët e Kosovës*, "Buletini i Muzeut të Kosovës", XI, Prishtinë, 1972; *Poezia popullore e Kosovës*, botuar në monografinë "Kosova dikur dhe sot", Beograd, 1973; *Balada popullore mbi trimin e sëmurë ndër shqiptarët dhe te popujt e tjerë ballkanikë*, "Rilindja", 7 Shtator 1974; *Epika popullore shqiptare mbi Luftën e Kosovës*, "Seminari i Kulturës Shqiptare për të Huaj", 2, Prishtinë, 1976; *Poezia popullore shqiptare në periudhën e Rilindjes Kombëtare*, "Seminari i Kulturës Shqiptare për të Huaj", 7, Prishtinë, 1982; *Truhellka si mbledhës dhe përkthyes i tregimeve popullore shqiptare*, "Seminari", 8, Prishtinë, 1983; *Mbi mitin letrar*, "Fjala", Prishtinë, 1983; *Veprimtaria e Jeronim de Radës në botmin e folklorit dhe të etnografisë*, "Gjurmime albanologjike-Folklor dhe etnologji", Prishtinë, 1986; *Vajet popullore shqiptare (Aspekti historik dhe tipologjik)*, "Seminar", 14, Prishtinë, 1989; *Heroi kosovar në këngët popullore shqiptare të Luftës së Kosovës*, "Gjurmime albanologjike-Folklor dhe etnologji", Prishtinë, 1991; *Skënderbeu në traditën popullore të shqiptarëve të Maqedonisë*, "Gjurmime albanologjike" - Folklor dhe etnologji, Prishtinë, 1993 etj.

Vepra "Poezia popullore shqiptare e Kosovës" është në të vërtetë disertacioni i doktoraturës. Në këtë studim monografik profesor Shefqet Pllana trajtoi gjendjen e sotme të këngës popullore të Kosovës. Kjo monografi është një studim sintetik i poezisë popullore shqiptare të trevave dhe të zonave të Kosovës, që paraqet një kontribut të vlefshëm në studimin e letërsisë popullore shqiptare në përgjithësi. Në të vihen në pah kategoritë e këngëve që janë në zhdukje e sipër si dhe kontinuiteti i poezisë popullore shqiptare të traditës në kushtet bashkëkohore të jetës së folklorit. Në mënyrë të veçantë ndriçohen sidomos brendia e këngëve, kompozicioni, struktura figurative, leksiku poetik, struktura muzikore-melodike etj.

Profesor Shefqet Pllana merrej edhe me përgatitjen e koleksioneve me lëndë folklorike për botim. Njëra ndër veprat më të njohura që la si bashkautor është përmbledhja: "Këngë popullore të Rilindjes Kombëtare", botim i Instituti Albanologjik të Prishtinës në shenjë të manifestimit të 100-vjejtorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Një fushë tjetër po kaq e rëndësishme e profesor Pllanës ishte edhe përgatitja e kuadrit të ri shkencor. Profesor Shefqet Pllana ishte studiues me individualitet të formuar shkencor.